



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1374 / prot. 2

Tiranë, më 01/04/2020

URDHËR

Nr. 220, datë 01.04.2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 158, DATË 11.03.2020, "PËR PEZULLIMIN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE INVALIDITETIT TË PUNËS"

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 10107 datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si edhe Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në pikën 3, të urdhrit Nr. 158, datë 11.03.2020, "Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës" togfjalëshi "deri në datën 3 Prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu